

VENDIM
Nr.684, datë 11.10.2006

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKË TURKE PËRMES
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NGA DHE PËR NË REPUBLIKËN E MALIT TË
ZI E KOSOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e një kompanie ushtarake transporti të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, të përbërë nga 75 (shtatëdhjetë e pesë) trupa dhe 26 (njëzet e gjashtë) mjete, të kalojë tranzit nga Mali i Zi për në bazën e Pashalimanit, Vlorë, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Hani i Hotit-Shkodër-Durrës-Vlorë-Pashaliman.

Hyrja e trupave ushtarakë turke të bëhet në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, më 15 tetor 2006.

Lejimin e një kompanie, me 58 (pesëdhjetë e tetë) trupa dhe 8 (tetë) automjete, të kalojë tranzit nga baza e Pashalimanit për në Malin e Zi, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Pashaliman-Vlorë-Durrës-Shkodër-Hani i Hotit.

Dalja e trupave ushtarakë turke të bëhet në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit më 20 tetor 2006.

2. Lejimin e një grupi ushtarak transporti të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, të përbërë nga 10 (dhjetë) trupa dhe 4 (katër) mjete ushtarake, të kalojë tranzit nga Kosova për në bazën e Pashalimanit, Vlorë, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Morinë-Kukës-Shkodër-Durrës-Vlorë-Pashaliman.

Hyrja e trupave ushtarakë turke të bëhet në pikën e kalimit të kufirit në Morinë, më 15 tetor 2006.

Lejimin e një skuadre ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, të përbërë nga 8 (tetë) forca dhe 2 (dy) automjete, të kalojë tranzit nga Pashalimani për në Kosovë, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në itinerarin Pashaliman-Vlorë-Durrës-Shkodër-Kukës--Morinë.

Dalja e trupave ushtarakë turke të bëhet në pikën e kalimit të kufirit në Morinë, më 20 tetor 2006.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/dhe nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Karvanët ushtarakë turke, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha